

NJË ZBULIM UNIK PËR ARKEOLOGJINË SHQIPTARE!



📍 Strikçan, Bulqizë

Gjatë punimeve të projektit kërkimor-shkencor “Kërkime Arkeologjike në Luginën e Bulqizës”, të udhëhequr nga Instituti i Arkeologjisë, është zbuluar varri i parë monumental i periudhës romake në Shqipëri, me përmasa mbresëlënëse dhe elementë të rrallë arkitektonikë e epigrafikë.

Monumenti (rreth 9 m x 6 m, me dhomë funerare 2.40 m të lartë) ka dalë në dritë me një mbishkrim bilingual romak, kushtuar individit të varrosur – Gelliano-s – dhe perëndisë Jupiter. Ky është mbishkrimi i parë i këtij lloji i zbuluar ndonjëherë në zonën e Dibrës.



Strukturat e sipërme sugjerojnë se monumenti ka pasur tipologjinë e një mausoleumi, duke e bërë këtë zbulim **të pazëvendësueshëm** për studimin e prapaktokës romake në Shqipëri. Për shkak të rëndësisë së veçantë, **Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore**, në bashkëpunim me **DRTK Tiranë** dhe në koordinim me **Institutin e Arkeologjisë**, do të ndjekin procedurat për vendosjen në mbrojtje paraprake të këtij siti arkeologjik.

DITARI MUJOR

SHTATOR
2025

NDËRHYRJE RESTAURUESE NË MANASTIRIN E SPILESË, GJIROKASTËR

Më 8 shtator, në ditën e shënuar të Lindjes së Hyjlindësës Mari, ndodhemi pranë përfundimit të punimeve restauruese në **Manastirin e Spilesë**, në Gjirokastrë, një nga monumentet më të çmuara të trashëgimisë sonë shpirtërore e kulturore.



Ndërhryrjet kanë përfshirë:

- Sondazhe arkeologjike dhe verifikime të themeleve.
- Pastrime dhe heqje të ndërhyrjeve të papërshtatshme.
- Konsolidim dhe restaurim të kupolave, qemerëve e mureve me gurë.
- Përforcim të strukturave me materiale bashkëkohore, në harmoni me teknikat tradicionale.
- Restaurim të dritareve, dyerve dhe elementeve të brendshëm e të jashtëm të kishës.

Falë këtyre punimeve, monumenti po rilind, duke ruajtur autenticitetin dhe duke qëndruar besnik historisë shekullore.



PUNIMET E RESTAURIMIT NË KISHËN E SHËN TODRIT, KADIPASHAJ

Një nga monumentet e çmuara të zonës po merr jetë të re!

Punimet e restaurimit në Kishën e Shën Todrit po zhvillohen me kujdes e profesionalizëm, duke konsoliduar strukturën, restauruar elementet arkitektonike dhe vendosur sistemin e drenazhit që do ta mbrojë nga dëmtimet.




Nën mbikëqyrjen e specialistëve të IKTK-së, ky proces synon jo vetëm ruajtjen e vlerave historike e shpirtërore të kishës, por edhe rikthimin e saj si një hapësirë e gjallë e identitetit kulturor të komunitetit.



INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE

DITARI MUJOR

DITARI MUJOR

SHTATOR
2025

PËRFUNDOJNË PUNIMET RESTAURUESE NË BANESËN “ANGONATËT”

Monument Kulture i Kategorisë I në Gjirokastrë



Kanë përfunduar punimet restauruese në banesën “Angonatët”, Monument Kulture i Kategorisë I në Gjirokastrë. Ndërhyrjet e kryera në çati, fasadë dhe elementët mbrojtës i kanë dhënë banesës një pamje të re, duke ruajtur autenticitetin dhe duke e mbrojtur për gjeneratat që do të vijnë.

Ky kompleks banimi është një dëshmi e rrallë e arkitekturës gjirokastrite, ku dritaret e shumta, ballkoni unikal dhe prania e tre oborreve tregojnë për zhvillimin e banesës qytetare dhe përshtatjen e saj me kohën.



NO.9

INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE

DITARI MUJOR

DITARI MUJOR

SHTATOR
2025**INSPEKTIM NË TERREN, PARKU ARKEOLOGJIK ANTIGONE-HADRIANOPOLIS***Në kuadër të hartimit të zonifikimit arkeologjik dhe rregullores së administrimit***Puna në terren përfshiu:**

- Vrojtje dhe vizitë përnjohëse të sitit dhe monumenteve të tij.
- Dokumentim fotografik përmes fotove në terren dhe imazheve ajrore me dron, të kombinuara me sistem gjeoreferencues.
- Marrje të pikave koordinative me sistem GPS, në përputhje me shtrirjen e sitit arkeologjik dhe potencialit përreth tij.
- Vlerësim i hapësirave jashtë kufijve të parkut arkeologjik që mund të kenë potencial arkeologjik.
- Diskutime me përfaqësuesit e DRTK Gjirokastrë mbi shtrirjen e zonës mbrojtëse dhe ndikimin e saj në ruajtjen e potencialit të plotë të sitit



ZBULIME TË REJA ARKEOLOGJIKE

si dhe projekte restaurimi, në Parkun Arkeologjik të Amantias.



Gjatë gërmimeve arkeologjike, u zbulua një element i panjohur më parë për arkeologët: **Muri rrethues i qytetit të poshtëm të Amantias**, i cili mendohet se është ndërtuar në shek. III p.Kr. dhe shkatërruar në shek. VI m.Kr.

Ky fortifikim i fuqishëm, **hedh dritë mbi organizimin urbanistik dhe publik të qytetit Ilir**, duke i shtuar një kapitull të ri historisë së kësaj qendre antike.

Veç këtij zbulimi, u realizuan edhe ndërhyrje **restauruese** të domosdoshme, për mbrojtjen e varreve monumentale, si dhe punime të tjera **konservuese**, mbi monumentet e evidentuara vitet e fundit, të cilat cënoheshin nga agjentët klimatik, si ngricat, shiu, etj

Zbulimet e reja arkeologjike, si **muri rrethues i qytetit të poshtëm të Amantias** dhe elementë të tjerë të organizimit urbanistik, së bashku me ndërhyrjet restauruese në **varret monumentale** dhe monumentet e tjera të evidentuara, po pasurojnë vazhdimisht peizazhin arkeologjik të Parkut.




Këto gërmime dhe restaurime jo vetëm që sjellin fakte të reja studimi mbi jetën e qytetit ilir, por edhe garantojnë ruajtjen dhe prezantimin e tyre për vizitorët e sotëm dhe brezat që do të vijnë.

INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE

DITARI MUJOR

DITARI MUJOR

SHTATOR
2025

PROJEKTI KËRKIMOR ARKEOLOGJIK " LUGINA E DRINIT NË MESJETË"



Projekti kërkimor Shqiptaro-Francez nën drejtimin e arkeologeve Etleva Nallbani dhe Elvana Metalla synon dokumentimin e strukturave ekleziale që shenjojnë urbanizmin e qytetit, duke eksploruar një sektor të ri, atë të qytetit të sipërm. Një rrethim i ri doli në dritë, duke e çuar në tre sistemin mbrojtës të Sardës.



Projekti ka ndërmarrë dhe studimin e plotë të banorëve mesjetarë praktikatat funerare, paleodemografisë, prodhimet e shkëmbimet ndërajonale. Falë bashkëpunimit të konsoliduar tashmë me DRTK Shkodër, u krye edhe një pastrim i territorit. Projekti kërkimor Arkeologjik, realizohet nga Ecole française de Rome, Centre National de Recherche Scientifique, Ministère de l'Europe et des affaires étrangères, INRAP, Institutit Arkeologjisë, me bashkëpunimin e Universitetit të Tiranës dhe DRTK Shkodër.



INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE

DITARI MUJOR

DITARI MUJOR

SHTATOR
2025

INSPEKTIM NË PARKUN ARKEOLOGJIK TË APOLONISË

Në kuadër të procesit të përditësimit të **zonifikimit arkeologjik** dhe **hartimit të rregullores së administrimit për Parkun Arkeologjik të Apolonisë**, specialistët e IKTK-së, në bashkëpunim me specialistët e parkut, realizuan një inspektim në terren, i cili konsistoi në:

- Dokumentimin fotografik të zonës arkeologjike.
- Hartografinë përmes marrjes së koordinatave në terren;
- Identifikimin dhe pozicionimin në hartë të zonave me potencial arkeologjik.



Ky proces synon mbrojtjen dhe menaxhimin e një prej siveve më të rëndësishme arkeologjike dhe historikë Shqipëri, duke garantuar ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe krijimin e kushteve për kërkime e studime të mëtejshme, në përputhje me kuadrin ligjor për mbrojtjen e zonave arkeologjike.

DITARI MUJOR

SHTATOR
2025

TAKIME BASHKËPUNIMI NË AMBIENTET E IKTK

Diskutim me ekipin e Universitetit POLIS:

Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit të datës 21 shkurt 2023 ndërmjet Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore dhe Universitetit POLIS, u zhvillua takimi i radhës.



Diskutimi u përqendrua tek njohja e Masterit Ekzekutiv në Konservim, Restaurim dhe Valorizim të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të ofrohet në vitin akademik 2025-2026, në Universitetin POLIS.

Një hap i rëndësishëm drejt forcimit të bashkëpunimit akademik dhe zhvillimit të kapaciteteve profesionale në fushën e trashëgimisë kulturore!

Me pjesëmarrjen e Znj. Kathryn Slocum, në ambientet e IKTK u zhvillua takimi me temë: Ngritja e kapaciteteve lokale dhe bashkëpunimi në zbatimin e ligjit për të luftuar trafikimin e paligjshëm të trashëgimisë kulturore shqiptare.

Në ambientet e IKTK, u zhvillua një takim me pjesëmarrjen e znj. Kathryn Slocum, eksperte ndërkombëtare për çështjet e trafikimit të paligjshëm të objekteve të trashëgimisë kulturore.

Gjatë takimit, znj. Slocum ndau reflektimet e saj mbi situatën aktuale në vend, bazuar edhe në vizitat që zhvilloi në disa nga parqet arkeologjike më të rëndësishme, si Apolonia, Bylisi dhe Antigonea.

Diskutimi u fokusua gjithashtu në:

- Sfidat me të cilat përballlet vendi në luftën kundër trafikimit të paligjshëm të trashëgimisë kulturore;
- Nevojat për trajnim dhe ngritje kapacitetesh të specialistëve dhe institucioneve përkatëse;
- Vlerësimi i përvojave nga trajnimet e mëparshme dhe diskutimi mbi programet në vazhdim.



DITARI MUJOR



SHTATOR
2025

TAKIME BASHKËPUNIMI NË AMBIENTET E IKTK

Diskutim ndërmjet përfaqësuesve të IKTK dhe Qendrës Kombëtare për Studime Shkencore
Universiteti i Sorbonës-Paris IV, Znj. Anne Cave dhe Znj. Marie-Patricia Raynaud.



Ky takim u zhvillua në kuadër të vijimit të projektit të përbashkët "Inventari i Trashëgimisë në Shqipëri, Inventari i mozaikëve në Shqipëri". Qëllimi final i këtij projekti është publikimi në disa volume i "Korpust të Mozaikëve të Shqipërisë".



Volumi i parë u botua në vitin 2018, mbi mozaikëte Butrintit, ndërsa volumi i dytë në Dhjetor 2024 dhe ka të bëjë me mozaikët e bazilikave përgjatë via Egnatia.

Fushata e këtij viti, do të përqendrohet në disa prej mozaikëve të banesës romake D "Vila e Athinasë" në Parkun Arkeologjik të Apolonisë.

Proceset e punës në terren do të përfshijnë:

- Dokumentimin grafik dhe ortofotografik me dron të mozaikëve.
- Dokumentimin e detajeve dhe përshkrimin e tyre.
- Studimin e materialeve dhe teknikave të realizimit.
- Ndërhyrje konservuese, me qëllim konsolidimin dhe ruajtjen e tyre in situ.




© Korpusti i Mozaikëve të Shqipërisë, Didier Dubois



INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE

DITARI MUJOR

DITARI MUJOR

SHTATOR
2025

DITA KOMBËTARE E TRASHËGIMISË KULTURORE

Leksion i hapur në Parkun Arkeologjik të Apolonisë.



Tema: Mozaikët e historisë sonë , një dritare drejt trashëgimisë kulturore.

29 Shtator, në kuadër të Ditës Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore, si dhe Ditëve Evropiane të Trashëgimisë Kulturore, në Parkun Arkeologjik të Apolonisë u zhvillua një **leksion i hapur mbi mozaikët**, me pjesëmarrjen e ekspertëve të mozaikëve nga **IKTK**, si dhe **ekspertëve ndërkombëtarë**.



U prezantua **Volumi nr. 2 i Korpusit të Mozaikëve**, një rezultat i një bashkëpunimi shumëvjeçar mes **IKTK** dhe **CNRS**.

Një ditë e veçantë për të ndarë njohuri dhe për të vlerësuar pasuritë tona kulturore!



NO.9